

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për auditimin ligjor të fondeve të përfuara dhe të shpenzuara nga **Partia “Lidhja Demokratike Shqiptare”**, Fushata zgjedhore 2009
Periudha 28/05/2009 - 28/06/2009

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Ne kemi audituar pasqyrën bashkëlidhur të fondeve të përfuara dhe shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë “Lidhja Demokratike Shqiptare” për periudhën 28/05/2009 deri 28/06/2009.

Kjo pasqyrë është përgjegjësi e Partisë Lidhja Demokratike Shqiptare “LDK”.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tonë.

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyra financiare është pa anomali materiale. Auditimi ynë përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrën financiare; vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësime të rëndësishme të bëra nga drejtimi i PDK; si dhe vlerësim të paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës. Ne çmojmë se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për opinionin tonë.

Politika kontabël e ndjekur nga ana e Partisë është të përgatisë pasqyrën bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave. Mbi këtë bazë, e ardhura njihet kur arkëtohet dhe jo kur fitohet, dhe shpenzimet njihen si të tilla kur paguhen dhe jo kur kryhen.

Për mendimin tonë, pasqyra bashkëlidhur e fondeve të përfuara dhe shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë “Lidhja Demokratike Shqiptare” jep një pamje të vërtetë dhe të drejtë të fondeve të përfuara dhe të shpenzuara për fushatën për zgjedhjet 2009, në përputhje me Ligjin nr. 10019, date 29/12/2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9228, date 29/04/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare”, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre.

Marije DUSHI - Auditor

Data 30/10/2009

PARTIA "LIDHJA DEMOKRISTIANE SHQIPTARE"

PASQYRA E FONDEVE TE PERFTUARA DHE SHPENZUARA.

Shënime për pasqyrën e fondeve të përfutuara dhe shpenzuara.

Fushata zgjedhore që përfundon më 28/06/2009.

Të gjitha balancat janë në LEKE, përveçse kur është shprehur ndryshe.

1. HISTORIA

Partia "Lidhja Demokratike Shqiptare" (LDK) është krijuar më 07/11/2007.

Rregjistrimi si person juridik në rregjistrin e partive politike është bërë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 11 555 Aktit dhe nr. 8 572 Vendimit.

"LDK" është një bashkësi politike e pavarur e hapur e organizuar mbi bazën e vullnetit të lirë të shtetasve shqiptarë, veprimtaria e së cilës rregullohet me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Drejtimi i "LDK" ,

Organet drejtuese të Partisë janë:

- Kongresi
- Këshilli Kombëtar i Partisë
- Kryetari
- Kryesia e Partisë

Kryetar i Partisë është z. Nikoll LESI

Objekti i veprimtarisë është:

- Mbrojtja e lirive themelore të njeriut, si dhe garantimin e së drejtës së pronës private, paqes, zhvillimit ekonomik, lufta kundër kriminalitetit, mbrojtja e sigurimit Kombëtar të R.SH
- Eshtë vazhduese e vlerave demokristiane
- Të promovojë në interes të Shqipërisë dhe shqipëtarëve lirinë e mendimit, dhe dinjitetin e individit, të drejtat dhe detyrat themelore të tyre, zhvillimin e inisiativës së lirë, tregun e lirë, etj.
- Të ndërtojë një demokraci të të drejtave të njeriut të njohura nga dokumentat ndërkombëtare
- Të kontribuojë në ndërtimin e shtetit ligjor
- Të nxisë dhe zhvillojë ekonominë e tregut nëpërmjet nxitjes së inisiativës së lirë ekonomike
- Të mbrojë lirinë e medias
- Të nxisë punësimin.

Selia e Partisë është në adresën: Rr. "Sami Frashëri", Pallatet e Aviacionit nr. 4, Tiranë
Burimet financiare janë:

- Kuotizacionet e anëtarëve
- Të ardhurat nga donacionet e ndryshme konformë ligjit
- Të ardhura të parashikuara me ligj

2. BAZA PER PREGATITJEN E PASQYRES SE FONDEVE TE PERFTUARA DHE SHPENZUARA (ARKETIMEVE DHE PAGESAVE)

2.1. Të përgjithshme

Pasqyra është përgatitur për qellimin e raportimit në Komisionin Qendror Zgjedhor sipas përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr. 10019, datë 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" si dhe me objektivat dhe udhëzimet për veprimtarinë/raportimin.

2.2. Marrëveshje të kontabilitetit

Pasqyra e fondeve të përfuara dhe shpenzuara janë përgatitur në bazë cash-I (parimi I arkëtim pagesave). Sipas këtij parimi, transaksionet rregjistrohen kur paguhen dhe jo kur ndodhin

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve përbëhet nga:

- a. Pasqyra e burimeve dhe aplikimit të fondeve të cilat paraqesin veças, fondet publike, fondet deri 100 mijë LEKE dhe fondet nën 100 mijë LEKE
- b. Pasqyra e shpenzimeve individuale dhe kumulative me aplikimin e tërheqjeve dhe kategorinë e shpenzimeve

3. DHENIA E FONDEVE

Partia "Lidhja Demokristiane Shqiptare" nuk ka përftuar fonde buxhetore në zbatim të nenit 87 të Ligjit nr. 10019, date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", pasi nuk ka qenë parti parlamentare në zgjedhjet pararendëse.

Gjatë fushatës elektorale 28 Maj - 28 Qershor 2009 janë përftuar gjithsej rreth 900 000 LEKE (500 000 LEKE dhe € 3 115),

Fondet janë përftuar tërësisht nga kandidati për deputet, njëkohësisht kryetar i Partisë "LDK" z. Nikoll LESI.

3.1 Fondet e mara deri më 28 Qershor 2009 janë detajuar në vijim;

Në kesh (arka) Arketimi		Dhuruesi	Deri më 28 Qershor 2009	
Nr.	Data		Në LEKE	€ EU
20	10/05/2009	Nikoll LESI (LDK)	100,000	-
21	11/05/2009	Nikoll LESI (LDK)	100,000	-
22	12/05/2009	Nikoll LESI (LDK)	100,000	-
23	13/05/2009	Nikoll LESI (LDK)	100,000	-
24	14/05/2009	Nikoll LESI (LDK)	100,000	-
Totali			500,000	
Banka				
X	X	Shteti (KQZ)	-	-
XJ	29/05/2009	Nikoll LESI	400,000	€ 3,115
Totali			500,000	€ 3,115

Fondet kesh (me LEKE në dorë) janë derdhur në arkën e LDK nga data 10/05-14/05/2009, pra në periudhën përgaditore që i parapriu fushatës zgjedhore.

Fondet janë përdorur për shpenzime të ndryshme operative në funksion të fushatës elektorale.

Fondet janë përfutur tërësisht nga persona fizik dhe janë marrë sipas përcaktimeve në nenin 89 të Ligjit nr. 10019, datë 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", janë dokumentuar sipas rregullave kontabël dhe janë përdorur në përputhje me kushtet e saktësuara në ligj, dhe konkretisht:

- a. Janë persona vendas
- b. Nuk janë përfutur sende ose shërbime me vlera më të mëdha se 1 (një) milion LEKE
- c. Nuk janë marrë fonde nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtëme (përveç rastit kur aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike):
 - Ka përfutur fonde publike, kontrata publike apo konçensione në 2 (dy) vitet e fundit me vlerë mbi 10 milion LEKE
 - Ushtron veprimtari në fushën e medias
 - Ka qenë partner me fondet publike në projekte të ndryshme
 - Ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të shtetit ose ndaj çdo institucioni publik

Të gjithë dokumentat mbështetëse rregjistri i posaçëm dhe llogaritë janë mbajtur në lidhje me gjithë aktivitetet.

- Rregjistri është plotësuar sipas përcaktimeve në nenin 90 të ligjit nr. 10019, date 29/12/2008
- Nuk janë përftuar dhurime nga fondet jopublike me vlerë më të lartë se 100 mijë LEKE, si rezultat nuk është çelur llogari të pasagme në një bankë nga subjekti zgjedhor.
- Shpenzimi total i Partisë, përfshirë dhe kandidatët e saj në fushatë nuk e kalon 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marë nga fondet publike , sipas nenit 87 të Kodit zgjedhor
- Çdo shpenzim i bërë për fushatë është dokumentuar duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi

4. PARAQITJA

4.1 Të ardhurat

4.1.1 Gjëndja e llogarive bankare

Gjëndja e mjeteve monetare në fund të periudhës paraqitet:

Llogarite	28/06/2009
UNION BANK (Arkëtime)	€ 3,115
UNION BANK (pagesa)	(€ 3,115)
Totali më 28/06/2009	-

Me bankë është kryesr vetëm një transaksion me vlerë € 3 115.

Me kontratën e publicitetit date 29/05/2009, ndërmjet Top Channel SHA dhe LDK, e përfaqësuar nga z. Nikoll LESI, është rënë dakort për transmetimin e spoteve publicitare në orare të përcaktuara me median, afrimin nga televizioni i të drejtës për transmetimin e tyre, sipas numrit, orarit të përcaktuar në mediaplanin dhe kushtet e rëna dakort.

Pagesa e parashikuar në këtë kontratë do të mbahet nga qiraja që televizioni mer nga z. Nikoll LESI (neni 1 dhe 6 i kontratës)

4.1.2 Gjëndja e arkës (kesh-i):

Llogaria	28/06/2009
	LEKE
Arkëtime	500,000
Pagesa	500,000
Gjëndja më 28/06/2009	-

Të gjitha fondet e përfuara janë deri në shumën 100 000 LEKE, për çdo dhurim.

5. Shtesë/(paksim) e periudhës

Gjëndja neto në fund të periudhës paraqitet:

Emërtimi	28/06/2009	
	LEKE	€
Të ardhura nga dhurimet	500,000	€ 3,115
Shpenzime	(500,000)	(3,115)
- Shpenzime për blerje karburanti	(182,250)	
- Shpenzime për postera	(12,000)	
- Shpenzime për flamuj etj për fushatën	(20,000)	
- Shpenzime për kanceleri	(35,750)	
- Shpenzime për spote publicitare	-	(3,115)
- Shpenzime për diata	(250,000)	
Gjëndja neto totale	-	-

Fondet e përfuara për fushatën, janë shpenzuar totalisht. Rezultati financiar për aktivitetin e fushatës është zero

Nikoll LESI
Kryetari i Partisë

Data 31/07/2009

LIDHJA DEMOKRISTIANE SHQIPTARE

TABELA E FONDEVE TE PERFTUARA NGA PARTIA "LIDHJA DEMOKRISTIANE SHQIPTARE" PREJ PERSONAVE FIZIKE OSE JURIDIKE
VENDAS, PER ZGJEDHJET PER KUVENDIN 2009

Nr.	Date	Përshkrimi i dhurimit	Vlera në LEKE/\$/EU	Identiteti i plotë i dhuruesit	NIPT-I	Data e dhurimit	Nr. i llogarisë ku u depozitua dhurimi	
20	10/05/2009	fonde te LDK	100.000,00	LDK (Nikolle Lesi)	K82403451B	10/05/2009	arka	
21	11/05/2009	fonde te LDK	100.000,00	LDK (Nikolle Lesi)	K82403451B	11/05/2009	arka	
22	12/05/2009	fonde te LDK	100.000,00	LDK (Nikolle Lesi)	K82403451B	12/05/2009	arka	
23	13/05/2009	fonde te LDK	100.000,00	LDK (Nikolle Lesi)	K82403451B	13/05/2009	arka	
24	14/05/2009	fonde te LDK	100.000,00	LDK (Nikolle Lesi)	K82403451B	14/05/2009	arka	
Shuma totale LEKE			500.000,00					
			Pesëqindmije					
XJ	29/05/2009	Nikoll Lesi	€ 3.115,00	LDK (Nikolle Lesi)		29/05/2009	Banke Union Bank	
Shuma totale €			€ 3.115,00					
			Tremijë e njëqind e pesëmbëdhjetë					

Për LDK

Nikoll LESI - kryetar i Partisë

PASQYRA E FONDEVE TE PERFTUARA DHE SHPENZUARA

FUSHATA ZGJEDHORE 2009

Burimet dhe përdorimi	Shenime	Periudha		Akumulimi nga fillimi I periudhes	
		deri 28/06/2009	deri 28/06/2009	Në LEKE	Në €
Financimi		Në LEKE	Në €	Në LEKE	Në €
Fonde të mara nga Shteti	3.1	-	-	-	-
Financimi nga persona fizik		-	-	-	-
Financime nga kandidati për deputet Nikoll LESI "LDK"	3.1	500,000	€ 3,115	500,000	€ 3,115
Financimi total		500,000	€ 3,115	500,000	€ 3,115
Përdorime	5				
Shpenzime për blerje karburanti		182,250	-	182,250	-
Shpenzime për postera		12,000	-	12,000	-
Shpenzime për flamuj e të tjera lidhur me fushatën		20,000	-	20,000	-
Shpenzime për kanceleri		35,750	-	35,750	-
Shpenzime për spote publicitare		-	€ 3,115	-	€ 3,115
Shpenzime për dieta		250,000	-	250,000	-
Përdorime totale për fushatën		500,000	€ 3,115	500,000	€ 3,115
Tepricë/përdorime fondesh		-	-	-	-
Bilanci i kesh në fillim të periudhës		-	-	-	-
Bilanci i kesh në fund të periudhës		-	-	-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare